



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA OBILIQ  
OPŠTINA OBILIQ  
MUNICIPALITY OF OBILIQ



**PLANI**  
**PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE**  
**KOMUNALE 2023-2027**

<b>1</b>	<b>Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave .....</b>	<b>6</b>
1.1	Qëllimi dhe fushëveprimi i planit.....	6
1.2	Baza ligjore për hartimin e planit.....	7
<b>2</b>	<b>Konteksti lokal .....</b>	<b>11</b>
2.1	Pozita gjeografike dhe klima .....	11
2.2	Resurset minerare dhe natyrore.....	12
2.3	Popullsia.....	13
2.4	Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit.....	15
2.5	Të dhënat mbi ekonominë lokale .....	19
2.6	Administrata publike.....	22
2.7	Dokumentet relevante komunale.....	24
<b>2.</b>	<b>Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave .....</b>	<b>24</b>
2.1	Të dhënat për mbeturina në komunë.....	24
2.2	Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave .....	25
2.3	Rishikimi i implementimit të planit.....	27
2.4	Performance e shërbimit .....	30
2.5	Performanca financiare e MM .....	31
2.6	Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave .....	32
2.8	Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave .....	33
	<b>Objektivat e MM dhe plani operacional .....</b>	<b>34</b>
2.9	Vizioni i MM .....	34
2.10	Objektivat dhe caqet e MM .....	34
2.11	Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave .....	34
2.12	Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave.....	37
2.13	Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM .....	44
2.14	Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit .....	48
2.15	Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave .....	49
<b>3</b>	<b>Plani i MM në kushte emergjente.....</b>	<b>50</b>
<b>4</b>	<b>Plani financiar, monitorimit dhe veprimit.....</b>	<b>51</b>

## Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës
ELV	Automobila mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
GIZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
QeK	Qeveria e Kosovës
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik
IWMS	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave
JICA	Agjencia japoneze e bashkëpunimit ndërkombëtar
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KIWER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
MESPI	Ministria e mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
MND	Mbeturina nga ndërtim/demolimi
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit
OECD	Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave
PPP	Partneriteti publik-privat
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave
WFD	Direktiva kornizë e mbeturinave

## Lista e tabelave

Tabela 1	Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2	Bilanci i mbeturinave komunale
Tabela 3	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Tabela 4	Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës
Tabela 5	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 6	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit
Tabela 7	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 8	Pajisjet për hudhjen, ruajtjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 9	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 10	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 11	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 12	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 13	Shpenzimet e sistemit të MM
Tabela 14	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 15	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 16	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 17	Lista e objektivave të planit
Tabela 18	Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 19	Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 20	Parashikimet demografike të popullatës
Tabela 21	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 22	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 23	Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen
Tabela 24	Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 25	Operacionalizimi i zgjerimit më shërbim
Tabela 26	Mbulimi me shërbim
Tabela 27	Treguesi i prezencës së deponive ilegale
Tabela 28	Efikasiteti i stafit
Tabela 29	Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 30	Korniza strategjike e objektivit 5
Tabela31	Korniza e veprimit dhe monitorimit

## Fjala e Kryetarit

Të nderuar qytetarë të Obiliqit,

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave që ju prezantojmë në këtë botim është i një rëndësie të veçantë për komunitetin e Obiliqit Ky plan përmbledh aspiratën tonë për mjedis të pastër e të shëndetshëm, me komunitet që redukton mbeturinat dhe riciklon çdo ditë, që përdor burimet në mënyrë të qëndrueshme, duke inkurajuar ekonominë e gjelbër. Këtë aspiratë të bashkësisë së Obiliqit do ta arrijmë bashkërisht, duke ndërmarrë hapat për ta përmbushur atë. Komuniteti dhe komuna jonë janë të angazhuar që nëpërmjet këtij plani t'i kontribuojmë zbatimit të politikës së BE-së dhe arritjes së objektivave kombëtare të Republikës së Kosovës për mbeturinat, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve. Në këtë mënyrë reduktojmë sasinë që prodhohet dhe që shkon në deponi dhe nëpërmjet një menaxhimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të mbeturinave, adresojmë sfidat e ndryshimit të klimës dhe uljen e gazrave që hidhen në atmosferë. Si rezultat i kësaj pune dhe bashkëpunimi të vyer, kemi përpiluar Planin tonë që përmban vizionin, fushat dhe objektivat tona synojnë menaxhimin bashkëkohor të mbeturinave duke na bërë pjesë të përpjekjeve globale në ruajtjen e mjedisit për brezat që vijnë. Jemi të vetëdijshëm se zbatimi i këtij plani ambicioz është një sfidë e madhe dhe kërkon mbështetje të vazhdueshme politike, financiare, fuqizim të kapaciteteve organizative dhe njerëzore të komunës dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetjen e plotë të komunës. Ne inkurajojmë qeverinë, donatorët dhe shoqërinë civile të na mbështesin në arritjen e objektivave të planit dhe realizimin e misionit të komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe krijimin e kushteve për mirëqenie të qytetarëve tanë. Ndërkohë ne do të punojmë për të rritur në vazhdimësi kulturën e ndarjes në burim të mbeturinave, mbështetjen ndaj iniciativave reduktuese dhe ricikluese, si dhe inkurajimin e një qytetarie aktive dhe partneriteteve të qëndrueshme me komunitetin dhe biznesin, si dy aktorët kryesorë në realizimin me sukses të planit. Komuna e Obiliqit më këtë plan shpreh jo vetëm angazhimin për të trajtuar mbeturinat si burim dhe vlerë për komunitetin, por dhe gatishmërinë për të marrë në konsideratë çdo zhvillim dhe prioritet kombëtar dhe rajonal që i kontribuon një komune të pastër, dhe tërheqëse për vizitorët. Në emër të qytetarëve të Komunës së Obiliqit, falënderoj kontribuesit gjatë hartimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, 2022-2027 në komunën e Obiliqit, Grupin punues në nivel komunal për hartimin e PKMM-së, GIZ, KIWER, CEDE dhe ekipin mbështetës teknik duke ju ftuar të gjithëve që këtë dokument strategjik ta konceptojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të rrisë cilësinë e jetës për të gjithë.

Ju faleminderit,

Kryetari i Komunës Z. Xhafer Gashi

# 1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

## 1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Objektivi i këtij PKMM është që të analizoj situatën aktuale të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës (organizimi, administrimi, rregulloret, financat, operimi dhe menaxhimi), të identifikoj çështjet dhe mangësitë, të vlerësoj pikat e forta dhe të dobëta, të propozoj rekomandime për përmirësime të gjendjes dhe përcaktoj vizionin, qëllimet dhe objektivat e reja (afatshkurtra, afatmesme), si dhe të hartoj një Plan Veprimi ku përcaktohen afatet kohore, kostot, autoritetet përgjegjëse si edhe indikatorët respektivë të suksesit për qëllime monitorimi.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin e administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM është i hartuar në mënyrën që merr për bazë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si në vijim:

PKMM trajton vetëm mbeturinat e ngurta, dhe nuk përfshihen mbeturinat e veçanta të cilat nuk janë kompetencë e komunës. Por do të përfshij raportimin e këtyre mbeturinave të institucionet përgjegjës siç është MMPH.

PKMM ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioriteteve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të tyre.
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;

- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

**Vizioni** - Komuna e Obiliqit duke u bazuar në synimin e përgjithshëm do të sigurojë që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë mbulueshmërin e 100 % të territorit të Komunës.

**Misioni**- Komuna e Obiliqit do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit. Kurse në një afat sa më shkurtër, komuna e Obiliqit planifikon që shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të bej në formë më modern respektivisht përmes mbledhjes së diferencuar për të inkurajuar riciklimin, reduktimin e mbeturinave, ndarja në burim dhe kompostimin.

**Vizioni** - Komuna e Obiliqit duke u bazuar në synimin e përgjithshëm do të sigurojë që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë mbulueshmërin e 100 % të territorit të Komunës.

**Misioni** - Komuna e Obiliqit do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit. Kurse në një afat sa më shkurtër, komuna e Obiliqit planifikon që shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të bej në formë më moderne respektivisht përmes mbledhjes së diferencuar për të inkurajuar riciklimin, reduktimin e mbeturinave, ndarja në burim dhe kompostimin.

#### **Masat e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave:**

- **Masa e Parë** - Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimit.
- **Masa e dytë** -Rritja e Mbulueshmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.
- **Masa e Tretë** - Krijimi i strukturave organizative;
- **Masa e Katërtë**- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese;
- **Masa e Pestë**-Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;
- **Masa e Gjashtë**-Planifikimi financiar për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- **Masa e Shtatë**-Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës.

#### **1.2 Baza ligjore për hartimin e planit**

Akti themelor për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinat i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi

menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjësive të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike **Ligji i Mbeturinave** përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitat sipas këtij Neni janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme me direktivat përkatës të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligjë përfshijnë: **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.**

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit .

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet rente të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen korporative, transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal të Komunave dhe Obilicëve përfshinë:

- **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012/2017**, Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- **VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË OBILIQIT**, Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obilicëve është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundeshe që mund të rezultojnë nga zbatimi i projekteve strategjike nga PZHK-së, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja hapësinore dhe mjedisore. Në raportin e VSM-së janë të përfshira edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga projektet strategjike nga PZHK

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- **Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë**- dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Dokumenti synon të trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.



Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012/2017**-Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjecare. Në një kapitull të vecantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave.
- **VLESRËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË OBILIQIT**, Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundeshe që mund të rezultojnë nga zbatimi i projekteve strategjike nga PZHK-së, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja hapësinore dhe mjedisore. Në raportin e VSM-së janë të përfshira edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga projektet strategjike nga PZHK

### 1.2.1 Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitet e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPHI dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Komunitet për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- **Ministria e Punëve të Brendshme** - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.

- **Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit** - është përgjegjës për rregullimin e aspekteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;
- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- **Drejtoria për Shërbimeve Publike (DSHPE)** - është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera publike. DSHPE është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave mbeturinave komunale dhe ayre nga ndërtimi dhe demolimi,
- **Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit** është përgjegjëse për caktimin e një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte , është përgjegjëse edhe për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit,
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa** - është përgjegjës për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- **Kompania KRM Pastrimi Njesia ne Obiliq për Mbeturina** ofron shërbim sipas statutit dhe kontratës të lidhur nga Komuna dhe Pastrimi

## 2 Konteksti lokal

### 2.1 Pozita gjeografike dhe klima

Pozita dhe veçoritë gjeografike Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10 km. në veriperëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: Komunën e Prishtinës, të Fushë-Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Besianës. Po ashtu, ka edhe një lidhje hekurudhore të rëndësishme me Fushë-Kosovën, si nyje hekurudhore dhe Mitrovicën. Territori i Komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 105 km<sup>2</sup> dhe zë një hapësirë rreth 1 % të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit “Sitnica” dhe lumit “Llap”, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në veri, po ashtu, në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).

*Pozita Gjeografike e Komunës së Obiliqit në Hartën e Republikës së Kosovës*



#### 2.1.2 Kushtet klimatike

Komuna e Obiliqit duke qenë e vendosur në fushëgropën e Kosovës, sikur mbahet mbi supet e maleve të Qyqavicës dhe Shalës së Bajgores. Kjo komunë përshkon tërthorazi këtë fushëgropë prandaj edhe ka një fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore prej 1,0531ha, që përbën 48% e territorit të komunës së Obiliqit, gjersa 37% është tokë pyjore. Miniera e re e Sibovcit do marrë më së shumti tokën e bukës, diku rreth 13% e territorit të komunës së Obiliqit. Në këtë fushë të paraparë për minierë sipërfaqësore, 86% e territorit është tokë e bukës ose ara kurse pjesa tjetër vendbanime, rrugë dhe pyje. Dukuria e ndërtimit përgjatë akseve rrugore është e theksuar edhe në komunën e Obiliqit, një sipërfaqe e konsiderueshme e kësaj pasurie është duke humbur nga ndërtimet e pakontrolluara kryesisht me përmbajtje biznesi. Sipas një analize të bërë në qendrat e mëdha urbane, për periudhën 1980 deri në vitin 2000 kur janë bërë fotografimet ajrore, është konstatuar se

zonat urbane nëse një zonë urbane ka pasur sipërfaqe prej 1.000 ha, pas periudhës së përmendur zona në fjalë është rritur në 2.700 ha, që do të thotë janë humbur

## 2.2 Resurset minerare dhe natyrore

Në territorin e Komunës së Obiliqit ka rezerva të mëdha të qymyrit të tipit linjit, që shfrytëzohen në minierat sipërfaqësore, pastaj gurë gëlqeror, të cilët ndodhen në fshatin Graboc i eperm dhe shkëmbinj që aktualisht përdoren me të madhe në infrastrukturën rrugore. Shfrytëzimi i këtyre mineraleve dhe materialeve ndërtimore në masë të madhe e ndotin mjedisin (ajërin, ujin dhe tokën) e Komunës së Obiliqit dhe krijojnë **mbeturina industriale** të cilat janë shumë të dëmshme për shëndetin e qytetarëve dhe kërkojnë një trajtim-menaxhim të veçant.

### Resurset ujore

Teritori i Komunës së Obiliqit është mjaft i pasur me ujëra, si sipërfaqësorë ashtu edhe nëntokësorë. Lumenjtë të cilët kalojnë nëpër territorin e Komunës së Obiliqit janë: **Sitnica, Drenica, dhe Llapi**. Pranë këtyre lumenjëve rrjedhin edhe një numër i vogël i prrockave. Përpos ujërave sipërfaqësorë, Komuna e Obiliqit është mjaft e pasur edhe me ujëra nëntokësorë. Këto ujëra nëntokësore (akuifere) kanë një shtrirje bukur të gjërë në territorin e Komunës së Obiliqit. Përdoren për pije dhe menaxhohen nga KUR (kompania e ujësjellësit rajonal) "Prishtina". Prej këtyre puseve me ujë të pijes furnizohet një pjesë e Komunes së Obiliqit në tërësi dhe më gjërë. Këto ujëra për fat të keq ndoten shumë nga rrjeti i kanalizimeve, mbeturinave të të gjitha llojeve etj.

### Hidrografia

Në territorin e Komunës ekzistojnë tre lumenj natyrorë që janë: "Sitnica", "Drenica" dhe "Llapi". Si dhe një kanal artificial që është Kanali Ibër - Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit "Ibër". Lumi "Sitnica" përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80 % të ujërave në drejtim të veriut. Lumi "Sitnica" derdhet në lumin "Ibër" në Mitrovicë

### Pyjet

Në territorin e Komunës, zënë një hapësirë prej 1.153 ha ose marrin 11% nga sipërfaqja e tërësishme e saj. Në pjesën perëndimore shtrihen pyje të ulëta që mbulohen nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardhi-Quercus Frainetto, Qarri - QurqusCerris, Shkoza e zezë Carpinus Orientalis, Ahu - Fagus Moesiaca.

### Shkatërrimi i pyjeve dhe kullotave


Prerja pa kriter e pyjeve dhe djegia e tyre prej veprimtarisë njerëzore, ndikon direkt në prishjen e ekuilibrave ekologjikë. Për këtë duhet rritur shkalla e ndërgjegjësimit të njerëzve për dëmin që po i shkaktojnë natyrës si rrjedhojë dhe shëndetit të tyre. Gjithashtu duhen

bërë përmirësime ligjore me qëllim që pyjet dhe kullotat të kalojnë në pronësi të komunës, pasi kujdesi ndaj tyre do të jetë shumë më i madh.

### 2.3 Popullsia

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaftë me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme.

Regjistrimi ASK 2011		Vlersimi ASK 2021	
Numri i popullsisë	Numri i amviserive	Numri i popullatës	Ngritje/Zbritje %
21549	4163	21549	-



#### Zonat kadastrale, sipërfaqja, vendbanimet, numri i popullsisë dhe dendësia

Zonat kadastrale	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Vendbanimet	Nr. i banorëve
Obiliq	12.50	Obiliq	6864
		Obiliq i vjetër	
Mazgit	6.38	Mazgit	2886
Llazareva	2.10	Llazareva	429
Millosheva	7.35	Millosheva	1819
Bakshi	2.03	Bakshi	602
Raskovë	0.92	Raskovë	640

Bajmofc	8.04	Bajmofc	392
Breznicë	14.32	Breznicë	1302
		Kozaricë	469
Plemetin	5.73	Plemetin	1381
Hamidi	1.74	Hamidi	147
Sibofci	7.51	Sibofci	963
Grabocfi i Epërm	8.60	Grabocfi i Epërm	341
Shipitullë	2.96	Shipitullë	291
Hade	4.91	Hade	534
Mirash	2.32	Mirash	
Lajthishtë	3.69	Lajthishtë	703
Palaj	7.11	Palaj	733
Dardhishtë	6.64	Dardhishtë	1053
<b>Totali</b>	<b>104.85</b>		<b>21,549</b>

**Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë** - ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate.

Komuna ka popullsi kryesisht të re, edhe pse, në periudhat e fundit kohore, vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mbi 35 % e popullsisë së përgjithshme në këtë zonë janë me moshë të re 0 deri 18 vjeç. Ndërsa, grup-moshat 19 – 35 vjeç e përbën mbi 25% të popullsisë, grup moshë 36 – 65 vjeç përfshin rreth 35% dhe moshë mbi 66 vjeç e popullsisë përfshin 4.9% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë si edhe e tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 60% të saj nën moshën 35 vjeçare.

Sa i përket raportit gjinor, ekziston një deballanc i vogël gjinor, në popullsinë e kësaj zone, ku popullsia mashkullore dominon me 51.1 %, në krahasim, me popullsinë femërore që ka 48.9 % të popullsisë së përgjithshme.

### **Migrimet e popullsisë**

Sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuara dhe shpeshherë reciprocikisht të lidhur e të kushtëzuar. Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri të rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve të ndryshme, mund të thuhet se ka migrime të theksuara kryesisht nga viset me të thella rurale drejt atyre urbane. Mirëpo, nuk duhet harruar se kemi të bëjmë edhe me migrime jashtë vendit, të cilët përbëjnë një numër të madh të popullatës. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike dhe të punësimit, sociale, demografike, politike etj. Shkaqet ekonomike dhe

punësimi janë ndër faktorët kryesor që i kanë kushtëzuar këto migrime, për faktin se në vendin tonë një numër i konsiderueshëm nuk kanë mundur të gjejnë punë dhe si zgjidhje e vetme për të siguruar kushte më të mira të jetesës ishte emigrimi në botën e jashtme.

### **Vendbanimet dhe tipi i vendbanimit**

Në tërë Komunën gravitojnë 20 vendbanime të shtrir në 18 zona Kadastrale Obiliq, Obiliq i vjeter , Mazgit i ultë, Mazgit i lartë , Llazarevë Milloshevë , Bakshi, Raskovë, Bajmofc, Breznicë, Kozaricë, Plemetinë, Hamidi, Sibovc, Grabofci I epërm, Shipitullë, Hade, Mirash, Lajthishtë, Palaj Dardhishtë.

Rreth 5648 banorë ndodhen në qytezën e Obiliqit që ka një rregullim urban, dhe rreth 19981 banorë në zonat rurale. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe, atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit si dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë, gjithashtu disponon me një fond banesor mjaftë cilësor.

## **2.4 Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit**

### **Biodiversiteti, Flora dhe fauna**

Në territorin e Komunës, gjer me tani, nuk ka ndonjë zonë që është shpallur e mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi për shkak të vlerave të biodiversiteti apo ekosistemeve me rëndësi. Ekosistemet natyrore në një pjesë të territorit të Komunës në masë të madhe është i ndikuar nga minierat, deponitë e djerrinave, termocentralet dhe deponitë e hirit të “TC-A dhe TC-B”, kështu që kemi një pamje të ashpër të peizazhit natyror. Në pjesët tjera të territorit të Komunës kemi një pamje të mirë të peizazhit natyror. Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, depozitat e hirit dhe depozitimet e djerrinës do të pastrohen, rrikultivohen dhe mbillen, rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizuale e peizazhit natyror.

### **Flora dhe Fauna**

Në afërsi të fshatrave mund të gjendet vegetacion i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden afër lumit “Sitnica” dhe përfshijnë livadhet e lagështa, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, dhe llojet e drurit të ahut, lisit, shkurret etj., që gjinden në perëndim. Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti,

grizhlat, sorrat, harabeli, kulumria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjenden veçojmë dhelprën, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj. Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit etj. Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, fëllënza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.

## **Ajri**

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm - kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile, si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze.

Burimet e ndotjes së ajrit në territorin e Komunës janë: Ndotja e ajrit nga aktivitetet minerare dhe minierat e qymyrit (linjitet); Ndotja e ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike në TC-A dhe TC-B; Ndotja e ajrit nga deponimi i hirit dhe; Ndotja e ajrit nga komunikacioni dhe sistemet ngrohëse banesore.

## **Uji**

Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore Në territorin e Komunës ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: "Sitnica", "Drenica" dhe "Llapi". Si dhe një kanal artificial që është Kanali Iber-Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit "Iber". Lumi "Sitnica" përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80 % të ujërave në drejtim të veriut. Lumi "Sitnica" derdhet në lumin "Ibër" në Mitrovicë.

Përgjatë lumit "Sitnicë" shtrihet një fushë, që përmbytet me ujë në sezonin e reshjeve të mëdha, në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy (2) blloqet e TC "Kosova B". Lumi "Sitnicë" është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit. Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë përmbajtje të madhe të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza. Të dhënat e përpiluara së mbi pikat e shkarkimit dhe marrjes së mostrave të cilësisë së ujit tregojnë që uji i lumit "Sitnicë" duhet kategorizuar si Ujë i Klasës IV, sipas sistemit të klasifikimit (pra, "ujë që mund të përdoret vetëm pas një trajtimi special") dhe është larg nga standardet evropiane të cilësisë



## **Zhurma**

Burimet për krijimin e zhurmës janë: • Zhurma që krijohet nga aktivitetet minerare dhe transporti i thëngjillit, pajisjet për eskavim dhe transport dhe shiritat bartës; • Rruga që qon në miniera, kryesisht shkaktohet nga kamionët për miniera dhe ata që bartin mbeturina, por edhe nga transporti i punëtorëve; • Shiritat transportues të linjitet; • Zhurma operative e “TC A”, si termocentral; • Zhurma në termocentral vjen nga shiritat bartës, pajisjet thërrmuese, ndezësit, turbinat, gjeneratorët, ventilatorët, kompresorët, pompat, kullat ftohëse dhe oxhaqet; • Operimi i lokomotivave të KEK-ut; • Bartja e hirit me shirit prej “TC A” në palosjen e hirit; • Vet procesi i palosjes së hirit dhe; • Dy llojet e fundit të burimeve të zhurmës janë pasojë e drejtpërdrejt e punëve aktuale të palosjes së hirit dhe mund të modifikohen ose largohen me aplikimin e koncepteve alternative të deponimit të hirit.

## **Trashëgimia natyrore**

Në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore siç janë: • Burim i ujit mineral në Graboc të Epërm; • Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (Palaj); • Trung druri i vetëm bliri (*Tilia spec.*), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe; • Grup trungjesh druri të bungut (3x *Quercus spec.*, 1x *Quercus cerris*), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc). Në territorin e Komunës nuk ekzistojnë zona natyrore të mbrojtura me ligj, por ekziston një zonë e veçantë e mbrojtur me ligj siç janë, Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve. Në këtë zonë janë të ndaluara këto aktivitete: • Ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi i mineraleve dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite nëpër zonat rurale dhe; • Ndërtimet apo zhvillimet që qojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit

degradim të biodiversitetit natyror në territorin e Komunës. Ndotja e mjedisit karakterizohet edhe nga aktivitetet urbane siç janë trafiku në komunikacion, menaxhimi joefikas i planifikimit hapësinor të territorit, trajtimi i ujërave të zeza-sanitare, si dhe menaxhimi jo i mirë i mbeturinave komunale

## **Rreziqet natyrore**

Vërshimet Komuna e Obiliqit përshkohet nga 3 lumenj: Sitnica, Drenica dhe Llap. Në komunën e Obiliqit janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jazë 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe kënetat 3.08 ha. Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Kastrioti, Kryshefc, CërkvenaVodicë, Plemetini dhe Hamidija. Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap. Përveç faktorëve natyror edhe faktori njeri ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet përmes disa aktiviteteve si : • Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve) • Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet • Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve • Mbjellja e

bimëve të larta si dhe atyre të vetë rritura pran brigjeve të lumenjve etj. • Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj. Thatësira Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla

### **Thatësira**

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

**Erozioni** rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon në sipërfaqet bujqësore dhe në vendbanime. Rreth 6.000 km<sup>2</sup> ose 56 % e territorit të Kosovës është e rrezikuar nga kjo dukuri natyrore që i takon shkallës së I, II, III të erozionit, (I erozion shumë i fortë, II erozion i fortë dhe III erozion i mesëm).

### **Rrëshqitja e tokës**

Në territorin e komunës së Obiliqit nga rrëshqitja e tokës (dheut) janë të prekura zonat rreth KEK-u si fshati Hade, Lajthishte, Sibovc, Shipitullë, Babimoc, Hamidi.

### **Tërmetet**

Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikrosizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore.

### **Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot spotet) Kosova A dhe B**

Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, Gjatë prodhimit të energjisë elektrike në termocentrale vjen deri te djegia e thëngjillit me ç „rast lirohen gazrat dhe pluhuri fluturues në formë të tymit dhe nëpërmjet të tymtarëve lirohen në atmosferë, ndërsa elementet tjera të cilat janë në përbërje të thëngjillit lirohen në formë të hirit dhe në formë të ujërave pas proceseve teknologjike. Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i imitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit.

**Deponia e Mirashit** - Kjo deponi e mbeturinave është regjionale dhe mbeturinat sillen nga Prishtina, Podujeva, Lipjani, Graçanica, Fushë Kosova dhe Drenasi. Deponia lëshon erëra të rënda dhe ndikon negativisht në gjendjen e ambientit.

## 2.5 Të dhënat mbi ekonominë lokale

### Zhvillimi Ekonomik

Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Bartësit kryesorë të zhvillimit ekonomik në Komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B, zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I-IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë-Mitrovicë.

### Sektori Energjetik

Eksploatimi i linjtit Eksploatimi i linjtit është duke u bërë që gati 100 vjet dhe operacionet e mëdha siç shihen sot me mihje sipërfaqësore dhe prodhim të energjisë elektrike kanë funksionuar që gati 50 vjet, pa ndonjë brengë për ndikimet në popullsi dhe mjedis. Veprimtarin ekonomike mbi këtë bazë e ushtron Korporata Energjetike e Kosovës - KEK sh. a. Minierat, TC-të dhe lokacionet e deponive janë prona të KEK Të dyja minierat aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar në të njëjtën zonë, duke avancuar në drejtime të kundërta. Në vitin 2005 ishte e domosdoshme të ndërmerren masa ristrukturimi, ngase dy mihjet e hapura sipërfaqësore të Bardhit e Mirashit ndërthureshin më masë të shtuar. Që atëherë të dyja mihjet e hapura sipërfaqësore zhvillohen si një minierë e vetme. Sido që të jetë, minierat edhe më tej quhen sipas emrave të tyre origjinal. Kanë filluar aktivitet minerare në dy miniera të reja në Sibovcin JP (në veri të Bardhit) dhe në sektorin Sitnica, afër fshatit Dardhishtë.

Pamje nga mihja sipërfaqësore e linjtit dhe simbolet e Korporatës Energjetike të Kosovë



### Planifikimet e ardhëshme të minierave dhe TC-ve

Me shfrytëzimin e rezervave të linjtit në mihjet Bardh dhe Mirash në vitin 2010-11, hapja e mihjes së re të linjtit me qëllim të furnizimit në kontinuitet të objekteve ekzistuese të gjenerimit, TC Kosova A dhe TC Kosova B, është çështje urgjente pasi që ndikon direkt në sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Zhvillimi i mihjeve të linjtit në periudhën e ardhshme është paraparë të ndodhë në pjesën veriore të basenit të linjtit "Kosova". Kjo pjesë njihet edhe me emrin "Fusha e Sibovcit" por me kërkesën e banorëve gjatë konsultimeve publike kjo fushë tani quhet "Mihja e Re".

Deri në futjen në prodhim të termocentralit “Kosova e Re” do të nevojitet zgjerimi i mihjes, si vazhdimësi e mihjes në pjesën Jug-Perëndim. Sasia totale e shfrytëzueshme e linjitet në “Mihjen e Re” vlerësohet të jetë 830 milionë ton, e që do të mjafton për furnizim me linjit gjatë 40 viteve të ardhshme.

Qeveria ka propozuar dhe Projekti për Asistencë Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL) ka mbështetur zhvillimin e një projekti të përbërë prej tre komponentëve, përmes investimit të drejtpërdrejtë të jashtëm:

- Ndërtimi i një termocentrali të ri, “Kosova e Re” me një kapacitet që do të mundësonte zëvendësimin në faza të kapaciteteve të vjetra të prodhimit (1,478 MW), dhe do të sigurohej furnizimi afatgjatë me energji elektrike me çmime konkurruese përderisa do të përmbushej kërkesa vendore,
- Rehabilitimi i blloqeve të caktuara në termocentralet ekzistuese deri në ndërtimin e blloqeve të para të Kosovës së Re, për të përmbushur kërkesën vendore në kuptimin afatmesëm, dhe
- Zhvillimi i një miniere të re për të furnizuar TC-A dhe B në kuptim afatmesëm dhe furnizim me lëndë djegëse për Kosovën e Re për kohëzgjatjen e vet operacionale prej 40 vitesh.

## **Kultura dhe Sporti**

### **Trashëgimia arkeologjike dhe kulturo-historike.**

Trashëgimia arkeologjike, arkitektonike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojllojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale.

Në disa pjesë të komunës sonë ka gjurmë të vendbanimeve të lashta. Ndonëse nuk janë bërë hulumtime arkeologjike të mirëfillta, megjithatë tashmë dihet që në Majën e Zezë në fillim të Çiçavicës, midis fshatrave Mjekaj, Shipitullë e Sibofc janë gjetur themele shtëpish, gurë të gdhendur, elemente metalesh, madje edhe grurë i karbonizuar, të gjitha këto gjetje që dëshmojnë për një vendbanim shumë të lashtë. Shumë nga objektet (dhe veçanërisht gurët) janë dëmtuar.

Është e nevojshme të bëhen hulumtime arkeologjike në teritorin e komunës.

**Tyrbja e Sulltan Muratit të I-rë** – Është vënë nën mbrojtje instituconale që në vitin 1950, dhe gjendet rreth 6 km në periferi të Prishtinës, në anën e majtë të magjistrales Prishtinë – Mitrovicë, në fshatin Mazgit.

## **Tregtia**

Tregëtia në këtë zone është bërë sektori më aktiv sidomos në dekadën e fundit. Tregëtia ka marrë hov në zhvillimin e saj në formë të bizneseve të vogla dhe të mesme. Ndërsa, shumica e ndërmarrjeve apo bizneseve të regjistruara në lokalitetet e fshatrave të kësaj komune janë biznese të vogla tregëtare që kanë të punësuar 2-3 persona.

Autoritetet në komunën e Obiliqit kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve, duke filluar nga: lehtësimi i qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për

plotësimin e kushteve ambientale, lejet e punës dhe tarifat e kapshme për biznese. nga të dhënat e regjistrimit të bizneseve rezulton se sektori i tregëtisë është dominues ndaj sektorëve të tjerë.

### **Bujqësia**

Si biznese, aktivitetet bujqësore në sektorin e bujqësisë nuk figurojnë të regjistruara mirëpo është evidente se ato janë ndër aktivitetet primare familjare. Në komunë, bujqësia është zhvilluar tradicionalisht nga familjet e mëdha dhe ka qenë aktiviteti kryesor ekonomik jashtë sektorit të energjisë dhe minierave. Përafërsisht 60% e popullatës që jetojnë në këtë rajon janë bujq që kultivojnë kryesisht grurin dhe misrin. Korreja dhe bluarja e drithrave kryesisht është e rregulluar në formë kooperative dhe në formë individuale. Nuk ka ndonjë fermë të madhe blegtorale, mirëpo kryesisht ka ferma të vogla dhe të mesme. Pronësia e tokës ndryshon sipas vendbanimeve, por shumica e banorëve kanë tokën në pronësi ku ata jetojnë dhe oborre e kopshte të vogla rreth shtëpisë që shfrytëzohen për prodhime bujqësore të nevojave vetanake. Sidoqoftë, rëndësia ekonomike e bujqësisë në zonë është në rënie. Sot shumë fusha me tokë kualitative bujqësore janë të lëna djerrë dhe shumica prodhojnë vetëm për konsum familjar.

### **Turizmi**

Turizmi në komunë nuk ka ndonjë zhvillim të dukshëm. Pasi që komuna e Obiliqit konsiderohet të jetë një nga zonat me mundësi më të mëdha të zhvillimit të industrisë se të sektorëve të tjerë të ekonomisë, turizmi si sektor ka zhvillim të limituar. Përfundimisht bën turizmi kulturor, por ky lloj i turizmit ka një sezon shumë të shkurtër. Një nga monumentet kulturo – historike të rëndësishme së madhe është “Tyrbja e Sulltan Muratit”, në fshatin Mazgit.

Mali i Qyqavicës i cili gjendet në pjesën veri-perëndimore të komunës, ka mundësi të zhvillimit të turizmit të gjuetisë.

### **Pylltaria**

Pyjet, në territorin e Komunës, zënë një hapësirë prej 1.153 ha ose marrin 11% nga sipërfaqja e tërësishme e saj. Në pjesën perëndimore shtrihen pyje të ulëta që mbulohen nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardi– Quercus Frainetto, Qarri – QuercusCerris, Shkoza e zezë Carpinus Orientalis, Ahu – Fagus Moesiaca.

### **Industria**

Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Ndër bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik në komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë 33 elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B dhe zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e thëngjillit. Veprimtarinë ekonomike mbi këtë bazë e ushtron Korporata Energjetike e Kosovës - KEK sh.a.. Minierat, TC-të dhe lokacionet e deponive të cilat janë prona të KEK sh.a. Zona e KEK-ut, gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e Lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra. Të dyja minierat

aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar në të njëjtën zonë duke avancuar në drejtime të kundërta. Ngjitur me TC A, gjendet një zonë e braktisur industriale ku kanë qenë në veprim impianti i gazifikimit të thëngjillit dhe azotikut deri para më shumë se 10 viteve.

### **Transporti**

Rrjeti rrugor në komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale. Nëpër komunën e Obiliqit kalon rruga nacionale që lidhë kryeqytetin, Prishtinën me Mitrovicën, ndërsa brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë 7.8km të kësaj rruge nacionale. Autoudha "Ibrahim Rugova" e cila ka hyrjen dhe daljen në fshatin Mazgit përshkon qytetin e Obiliqit në pjesën perëndimore të territorit të komunës si dhe përveç lidhjes me Shqipërinë përmes saj bëhet qarkullim më i mirë dhe i shpejtë për në aeroportin "Adem Jashari".

### **Infrastruktura e energjisë elektrike**

Në komunën e Obiliqit ka një rrjet i shtrirë mjaft dendur dhe ky rrjet është në pronësi të ndërmarrjeve energjetike të cilat menaxhojnë me rrjetit kombëtar si KEK-ut, KOSTT-it dhe KEDS-it. Kjo dendësi e rrjetit ka ndikim si në aspektin mjedisor po ashtu edhe vizual, pasi që në këtë komunë ndodhen dy termocentralet: TC Kosova A 220/110/35 kV TC Kosova B, 400/220 kV. Këto nënstacione janë pika te forta të sistemit elektro-energjetik të Kosovës, prej nga dalin një numër i madh i linjave 400 kV, 220 kV dhe 110kV. Pastaj në territorin e komunës së Obiliqit janë të shtrira mihjet sipërfaqësore nga të cilat bëhet furnizimi i termocentraleve me thëngjill, nënstacionet Kosova B dhe Kosova A. Konsumi i komunës së Obiliqit furnizohet nga nënstacionet 35/10 kV dhe atë: Mazgiti, Bardhi dhe Fushë Kosova.

### **Infrastruktura e ujësjellësit**

Në Komunën e Obiliqit ekzistojnë dy (2) sisteme vijuese për furnizim me ujë cilësorë të pijes: Sistemi i Batllavës që menaxhohet nga KUR "Prishtina" e që furnizon 70 % të zonës urbane të Obiliqit dhe tetë (8) vendbanime tjera rurale me ujë, një (1) sistem tjetër (puset në "Obiliq i Vjetër") që menaxhohen nga KUR "Prishtina" që furnizon 30 % të zonës urbane të Obiliqit dhe pesë (5) vendbanime tjera rurale, dhe disa vendbanime nga burimet nëntokësore nga bunarët individual, të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes dhe nuk janë në përputhje me AI 2/99 MSHM.

## **2.6 Administrata publike**

Aktualisht në Komunën Obiliq janë nën varësi të Kryetarit të Komunës 11 Drejtori, ku në varësi të Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit merret, ndër të tjera, edhe meçështjet e shërbimit të manaxhimit të mbeturinave. Komuna e shikon si shumë të nevojshme, nisur edhe nga detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore që ia ngarkon kuadri ligjor, të ngrihet një sektor i veçantë për shërbimin e manaxhimit të mbeturinave në varësi të kësaj drejtorie. Në pamundësi të krijimit të një sektori, komuna propozon krijimin e një pozicioni të ri „zytari për mbeturinat" në varësi të Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit. Si në rastin e sektorit ashtu edhe në rastin e zyratrit për mbeturinat do të jenë të dedikuar plotësisht sistemit të manaxhimit të mbeturinave, duke ndjekur hapa pas hapi zbatimin e planit dhe

monitorimin e vazhdueshëm të kompanive publike dhe private për shërbimin e manaxhimit të mbeturinave.

Ndonëse kuadri ligjor i delegon të drejta komunës në lidhje me shërbimin e manaxhimit të mbeturinave, mungesa e burimeve njerëzore dhe burimeve financiare në komunë për manaxhimin e këtij shërbimi, ka çuar në një situatë, ku cilësia e shërbimit të ofruar nga të dy kompanitë nuk është në standardin e kërkuar, si pasojë e mos kontrollit dhe monitorimit rigoroz nga komuna.

### **Shëndetsia**

Në territorin e komunës, në sektorin publik shëndetësia është e organizuar në nivelin parësor.

Shërbimet shëndetësore ofrohen në 8 objekte shëndetësore, ku një prej tyre është Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare e cila ndodhet në Obiliq ndërsa të tjerat janë Qendra të Mjekësisë Familjare të cilat ndodhen në: Milloshevë, Plemetin, Breznicë, Palaj dhe Sibovc dhe Ambulanta në Shipitullë dhe Babimoc.

Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje të konsiderueshme.

Gjithashtu duhet cekur se në këtë territor ofrohen shërbime mjekësore edhe nga sektori privat. Gjendja e mirë shëndetësore është shumë e varur edhe nga indikatorët mjedisor, në radhë të parë nga ajri, uji për pije, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor.

Numri i problemeve shëndetësore, që vijnë si pasojë e ekspozimit ndaj mjedisit, është gjithnjë në rritje, posaçërisht të fëmijët.

### **Arsimi**

Sistemi i edukimit-arsimit në komunën e Obiliqit është i organizuar në tri nivele: arsimimi parafillor, fillor dhe i mesëm.

Në komunën e Obiliqit arsimimi është i organizuar në gjashtë shkolla fillore në gjuhën shqipe, katër shkolla fillore në gjuhën serbe dhe dy shkolla të mesme, numri i objekteve shkollore gjithsej është 21, duke përfshirë edhe shkollat e mesme. Në procesin mësimor janë të përfshirë rreth .... nxënës.

Në vitin 2002, u krijua një model i ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e reformuar ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ulët të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re, arsimi i obligueshëm është zgatur për një vit, tani në 9 vite nga ai i mëparshmi me 8 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor është e organizuar në katër nivele: Arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I–V), arsimin e mesëm të ulët (VI–IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X–XII).

Për fëmijët e moshës nën 5 vjet brenda territorit të komunës është e organizuar një çerdhe. Arsimi parafillore hasim tek një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore që ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç.

## 2.7 Dokumentet relevante komunale

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012/2017- Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjecare. Në një kapitull të vecantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave.

Vlerësimi strategjik mjedisor i planit zhvillimor komunal të Obiliqit, Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimin Komunal të Komunës së Obiliqit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundeshe që mund të rezultojnë nga zbatimi i projekteve strategjike nga PZHK-së, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja hapësinore dhe mjedisore. Në raportin e VSM-së janë të përfshira edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga projektet strategjike nga PZHK

## 2. Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave

### 2.1 Të dhënat për mbeturina në komunë

#### Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave:

Bazuar në Raportin vjetor të AMMK për vitin 2021 gjenerimi i mbeturinave në Komunën e Obiliqit është paraqitur në tab. 5. Komuna e Obiliqit nuk ka zhvilluar ndonjë analizë të gjenerimit të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave të grumbulluara në bazë të peshimit në deponinë lokale të Tuçepit ku dërgohen të gjitha mbeturinat.

<b>Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara 2021 nga KRM "Pastrimi" NJOP Obiliq</b>				
Viti	Mbeturina të grumbulluara nga Ambienti (ton)	Mbeturina të grumbulluara nga deponitë ilegale (ton)	Mbeturina të ripërdorura / ricikluara	Totali i sasisë së mbeturinave të deponuara nga Ambienti (ton)
2021	7,152 t	NA	-	7,152 t

Në lidhje me kompozicionin/ përbërjen e mbeturinave nuk është bërë ndonjë analizë. Meqë në lidhje me kompozicionin e mbeturinave do marrim si analizë vlerësimi nga rasti i



Komunës së Pejës. Përbërja e sasisë dhe llojit të mbeturinave e cila ka rezultuar nga analizat ka qenë ma vijon, shih tabelen 6.

Tabela 6. Kompozicioni i mbeturinave bazuar në analizën e kompozicionit të mbeturinave 2020-2021 (komuna e Pejës).

Lloji i mbeturinave	Analiza e parë A1 2021		Analiza e dytë A2 2022		Mesatarja nga A1 dhe A2
	Kilogram	Përbërja në %	Kilogram	Përbërja në %	Përbërja në %
<b>Mbaturinat Komunale</b>					
Letër dhe karton	439.63	21.30%	355.3	17.00%	19.15%
Qelq	119.71	5.80%	148.39	7.10%	6.45%
Mbaturina të biodegradueshme	633.65	30.70%	798.38	38.20%	34.45%
Tekstil	132.10	6.40%	110.77	5.30%	5.85%
Plastikë	392.16	19.00%	415.91	19.90%	19.45%
Metal	22.70	1.10%	20.9	1.00%	1.05%
Mbaturina tjera komunale	324.05	15.70%	240.35	11.50%	13.60%
<b>Totali në kg dhe në %</b>	<b>2,064</b>	<b>100.00%</b>	<b>2,090</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>

## 2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

### Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit bëhet nga KRM "Pastrimi" , njësi operative në Obiliq. KRM " Pastrimi", është nën përgjegjësin dhe i autorizuar nga Komuna e Obiliqit.

Komuna e Obiliqit e ka themelue edhe ndërmarrjen komunale lokale "Kastrioti" e cila për momentin është e ngarkuar me pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike.

Krahas këtij operatori ekzistojnë edhe 4 operatorë të riciklimit të cilët nuk janë pjesë e sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave në komunë dhe rrjedhimisht nuk dihet mbi sasinë e mbeturinave të cilën e grumbullojnë dhe menaxhojnë.

**Tabela 3: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale**

	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhuar e mbeturinave	Mbulimi me shërbim %	Statusi i kontraktimit (po/jo)
Operatori 1	Krm "Pastrimi" Sh.A.	Publike	Komunale	100	po
Operatori 2	NPL "KASTRIOTI"	komunale	Mirmbajtjen e hapësirave publike	//	Kontrat ne shtepi

**Tabela 4: Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës**

	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e mbeturinave të menaxhuara	Sasia e mbeturinave të menaxhuara
Operatori 1	Italy recycling	Private	Leter dhe karton	NA
Operatori 2	N.SH.T. Kanalprofis	Private	Leter, qelq, plastik, metal	NA
Operatori 3	ECO KOS" L.L.C	Private	Vajra dhe yndyrna ushqimore	NA
Operatori 4	Quatra Balkans" L.L.C	Private	Vajra dhe yndyrna ushqimore	NA

#### Mbulimi me shërbim:

Mbulimi më shërbim për grumbullim të mbeturinave në Komunën e Obiliqit është 85%, shih tabelen 10. Nese krahasohet më vitin 2021, mbulueshmeri është rritur për 3%.<sup>1</sup>

Tabela 10: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës <sup>3</sup>						
Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
KRM "Pastrimi"	3852	3274	602	268	33	33

#### Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Ofrimi i shërbimit për grumbullim të mbeturinave në Komunën e Obiliqit është e ndarë dy zona: zona urbane qendra, dhe zona rurale. Në qytet mënyra predominante e shërbimit është me kontejnerë të përbashkët ndërsa në zonën rurale forma e shërbimit është derë më derë. Frekuenca e shërbimit për zonën urbane është 1 – 2 herë në ditë varësisht nga sezona dhe gjenerimi i mbeturinave ndërsa në zonën rurale mbeturinat grumbullohen një herë në javë. Sa i përket infrastrukturës ndarëse ajo nuk ekziston në komunë dhe mbeturinat hedhen në kontejnerë/shprta në mënyrë të përzier dhe si të tilla grumbullohen nga operatori.

Tabela 12: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit				
Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit

<sup>1</sup>Raporti për gjendjen e mbeturinave në Kosovë për vitin 2021, AMMK (2022)

Zona urbane qendra <sup>2</sup>	15%	7 dite në javë	85%	7 dite në javë
Zona rurale	100%	1 here në javë	-	

### Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale janë nën menaxhimin e KRM"Pastrimi", shih tabelen 8. Në Obiliq shumica e mjeteve të hudhjes së mbeturinave janë shportat 120l dhe kontejnerët 1.1m<sup>3</sup>. Gjendja e këtyre pajisjeve të hudhjes është kryesisht e mirë megjithatë nevojiten investime të vazhdueshme në ripërtëritjen e tyre.

Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje funksionale %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l	2526	68%	32%	-
Kontejnerë 1.1 m <sup>3</sup> metalik	180	76%		24%
Kontejnerë 1.1 m <sup>3</sup> plastikë	62	100%		

Mjetet për transportin e mbeturinave (kamionët) dhe mjetet tjera të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale përfshi edhe atë të transferit, që janë nën menaxhimin e KRM"Pastrimi", janë paraqitura në tabelen 9. Operatori i shërbimit ka në dispozicion një autopark prej 4 kamionëve të cilët janë në gjendje të mirë operative. Kompania posedon edhe një traktor për grumbullim të mbeturinave në zonat me qasje të kufizuar.

Brendi	Tipi	Kapaciteti ton apo m <sup>3</sup>	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja (e mirë /funksionale/eke qe)
Isuzu	Kompaktor	3.7 ton	2018	01-318-LT	Mirë
Isuzu	Kompaktor	3.7 ton	2019	01-350-PG	Mirë
Mitsubishi	Kompaktor	4.0 ton	2009	01-247-BS	Funksionale
Mercedes	Kompaktor	5.0 ton	2022	01-147-SP	Mirë
Ferguson	Traktor	1.5 ton	2000	IMT - 16	Funksionale

### **2.3 Rishikimi i implementimit të planit**

Komuna e Obiliqit në planin e menaxhimit të mbeturinave, ka pasur 7 objektiva kryesorë si: hartimi i kuadrit ligjor për MM, konsolidimi i shërbimit, nxitja e iniciativave për minimizimin e gjenerimit të mbeturinave, rritja e nivelit të arkëtimit, mbledhja e ndarë e mbeturinave në fraksione të caktuara, si dhe eliminimi i deponive ilegale.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar më detajisht objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre, si dhe janë dhënë komentet konkrete për secilin

<sup>2</sup>Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

objektiv. Në përgjithësi rezultatet e realizimit të caqeve janë modeste për shkak të mungesave infrastrukturore dhe kapaciteteve institucionale. Poashtu vlen të ceket se edhe disa objektiva të planit nuk kanë qenë realiste dhe disa tjerë jo dhe gjithaq relevante.

Sido që të jetë ky rishikim i PKMM aktual, duhet të na shërbej si një mësim dhe si orientim për hartimin e PKMM në vijim, me qëllim që të adresohen qartë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në mospërbushjen e objektivave.

DRAFT

**Tabela 10: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual**

	Objektiva e MM	Treguesi i performancës	Caku	Realizimi	Favorshëm / pafavorshëm	Koment
1	Mbulimi me sherbim	%	100%	85%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
2	Ndarja e mbeturinave në burim	%	50%	-	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
3	Trajtimi i mbeturinave	%	60%	-	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
4	Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura në mbeturina komunale	%	60%	-	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
5	Hartimi I Rregullores komunale	1	1	1	Favorshëm	
6	Caktimi I tarifave të mbeturinave	1	1	1	Pafavorshëm	
7	Kontraktimi I operatorëve	2	2	1	-	Mungesa e operatorit të licencuar për MND
8	Elimini I deponive ilegale		0		86%	

## 2.4 Performance e shërbimit

### Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve përfshin stafin direkt e angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të MM. Numri i stafit total është 42 dhe raporti staf direkt staf administrative është 52% / 48%. Në përgjithësi efikasiteti i stafit të KRM „Pastrimi“ në komunën e Obiliqit nuk është i favorshëm sidomos nëse treguesi kalkulohet për konsumatorë të shërbyer që shpalos mbistafim (joefikasitet të theksuar operativ).

Numri i stafit ofrues të shërbimeve në menaxhimin e mbeturinave janë gjithësejt 22. Për vitin 2021, efikasiteti i shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në Komunën e Obiliqit është paraqitur në tabelen 11.

<b>Kategoria</b>	<b>Numri i stafit</b>
<b>Stafi direkt</b>	
Kryepunëtorë	1
Shoferë	6
Punëtorë	15
Total staf direkt:	22
<b>Staf indirekt dhe administrativ</b>	
Drejtorët e bordit	1
Menaxhmenti i lartë <sup>3</sup>	2
Zyrtarë të rangut të mesëm	11
Staf teknik	
Zyrtarë të rangut fillestar	6
Staf tjetër	
Total staf indirekt dhe administrative:	20
Total staf të MM	42
Mbeturina të grumbulluara	7,152 ton
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	5,87
EF të shërbyera	3,274
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	12,8

### Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit:

<sup>3</sup>KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

KRM "Pastrimi", e cila operon në Komunën e Obiliqit, ka këtë performancë të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave, shih tabelen 12. Konsumi i naftës mesatare është 3,2 l/ton dhe i njëjti është mjaft i lartë edhe komuna e Obiliqit e ka deponinë afër. Në këtë joefikasitet ka ndikuar mungesa e planit të detajuar operativ si dhe prezenca e makinerisë së vjetëruar e cila nuk është efikase.

<b>Tabela 12: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave</b>	
<b>Kategoria</b>	<b>Performanca</b>
Kamionët në operim	Kater (4) kamion në operim
Kapaciteti maksimal operues (ton)	17.9 ton për gjiro
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	7152.62 ton
Xhiro(xhiro/vit)	2032 gjiro
Konsumi i naftës (l/vit)	22658.44 liter
<b>Efikasiteti i Shfrytëzimit %</b>	<b>100%</b>
Konsumi i naftës l/100km	NA
Konsumi i naftës l/ton	3.17 l/ton

## 2.5 Performanca financiare e MM

### 2.5.1 Shpenzimet e shërbimit të MM

Shpenzimet e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave për Komunën e Obiliqit për vitin 2021 janë të paraqitura në tabelen 13. Struktura e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve shpalos faktin se shumica dërmuese e shpenzimeve shkojnë në paga dhe shpenzime administrative ndërsa amortizimi është zero për shkak të aseteve të vjetëruara. Operatori duhet të përmirësoj efikasitetin e operimit për të siguruar fonde shtesë për investime të ripërtëritjes kapitale.

<b>Tabela 13. Shpenzimet e shërbimit të MM</b>		
<b>Kategoria e kostove dhe shpenzimeve</b>	<b>Kostot (€/vjet)</b>	<b>Pjesëmarrja %</b>
Shpenzimet e pagave	215133.9 €	74,3%
Shpenzimet e materialit direkt <sup>4</sup>	62118.2 €	21,4%
Shpenzimet indirekte dhe administrative	12457.5 €	4,3%
Amortizimi		
Total:	289709,6 €	100%

### 2.5.2 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Të hyrat nga arkëtimi i shërbimit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit e bënë KRM "Pastrimi". Sipas raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave për të hyrat dhe arkëtimin janë të paraqitura në tabelen 14. Amvisëritë janë kategoria më e rëndësishme e të hyrave 57%

<sup>4</sup>Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

e pasuar nga bizneset 23,6% dhe institucionet 9%. Shkalla e arkëtimit është 97% për shkak të arkëtimit të borxheve të vjetra ndërsa për amvisëri ajo është 96%.

<b>Tabela 14: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM</b>				
Të hyrat operative	Të hyrat		Arkëtimi	
	€	%	€	%
-Amvisëritë	180188,6	57,35%	173570	96,33%
-Bizneset	74159	23,60%	68313,7	92,12%
-Institucionet	28445,9	9,05%	29808,1	104,79%
-Nga shërbimet tjera të kontraktuara	31391,8	9,99%	33870,1	107,89%
Total:	314185,3	100%	305561,9	97,26%

### 2.5.3 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Mbulimi i kostos dhe efikasiteti për menaxhimin e mbeturinave komunale në Obiliq për vitin 2021, është paraqitur në tabelen 15. Komuna e Obiliqit i mbulon kostot sipas të dhënave të deponuara.

<b>Tabela 15: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit</b>	
Kostot e MM	289710 €
Të hyrat e MM	314185€
Arkëtimi	305561€
Shkalla e mbulimit nga faturim %	108%
Shkalla e mbulimit nga arkëtimi %	105%
Kosto për ton të mbeturinave	

## 2.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

### Deponia

Komuna e Obiliqit shërbehet me deponinë e Mirashit e cila gjendet në territorin e saj brenda deponisë së hirit të KEK e cila menaxhohet nga KMDK. Të gjitha mbeturinat e grumbulluara nga komuna dërgohen në këtë deponi për deponim. Tarifa e deponimit është 6,07 €/ton për mbeturina komunale ndërsa 50 €/ton të qelqit dhe mbeturinave shtazore nga therrëtoret. Megjithatë këto tarifa priten të rriten progresivisht me fillim nga viti 2023 e tutje. Poashtu kjo deponi pritet të mbyllet dhe mbeturinat do të dërgohen në deponin në Lipjan gjë që do rezultojë në zgjatjen e rrugëtimit dhe kostove të transportit.



## 2.8 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

- Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme

Menaxhimi i këtyre mbeturinave ende nuk është i organizuar në komunën e Obiliqit dhe kjo shihet si njëra nga shkaqet e prezencës së hudhjes së këtyre artikujve rreth kompjuterëve dhe në deponi ilegale.

- Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi:

Komuna ka caktuar lokacion për MND por kjo deponi nuk është e pajisur me infrastrukturë adekuate. Poashtu komuna nuk e ka kaluar procesin tariforë. Për shkak të dobësive në zbatimin ligjor është e shprehur hudhja e këtyre mbeturinave në vende të paërshtatshem duke i dhënë hov dukurisë së deponive ilegale në komunë.

- Menaxhimi i mbeturinave shtazore

Këto mbeturina shpeshherë hedhen në kontejnerë komunal dhe për rrjedhojë dëmtohet operatori i cili detyrohet të paguaj tarifa të larta si dhe në deponi ilegale. Poashtu mosrealizimi i qendrës përpunuese në Zonën Industriale Drenas e ka dëmtuar këtë kategori të mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave medicinale

Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave mjekësore bëhet nga kompani të licensuara të cilat fraksionet e mprehta dhe pajisjet i dërgojnë për sterilizim ndërsa pjesën infektive për incinerim tek qendra rajonale spitalore. Megjithatë menaxhimi i kësaj kategori të mbeturinave nuk është në nivelin e dëshiruar.

- Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Kompani private të pajisura me Licenceë për menaxhim të mbeturinave që veprojnë në komunën tonë janë:

Italy recycling, kompani për mbledhje, grumbullim, klasifikim dhe trajtim të mbeturinave komunal (leter)

N.SH.T. "Kanalprofis" Mbledhje dhe bartje të mbeturinave komunale si dhe mbledhje, grumbullim, dhe trajtim fizik të mbeturinave komunale (leter, qelq, plastik, metal)

"ECO KOS" L.L.C. Mbledhje dhe grumbullim të Mbeturinave vajra dhe yndyrna ushqimore

"Quatra Balkans" I.L.C. Mbledhje dhe grumbullim të Mbeturinave vajra dhe yndyrna ushqimore

## Objektivat e MM dhe plani operacional

### 2.9 Vizioni i MM

Komuna e Obiliqit synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar më qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

### 2.10 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme (edhe pse lista nuk është e kufizuar):

Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

### 2.11 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Obiliqit është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Treguesi i performancës	Vlera bazë	Caku
-------------------------	------------	------

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pcp /ditë)	1.05	1.0	0.95	0.90	0.85	0.80
Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e gjenerimit	-	-	1	-	-	-
Zbatimi i tarifave volumetrike	-	-	-	1	-	-
Futja e pakos stimuluese	-	-	-	1	-	-
Shpërndarja e komposterëve individual	-	640	640	640	640	640
Zbatimi i fushatës informative						

### 2.11.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

#### Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin nevojitet:

- **Plani i riorganizimit të shërbimit** i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara
- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT

#### Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike nevojiten aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes
- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifën e bazuar në matje

- Zbatimi i tarifave PAYT

**Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim“ dhe „zero mbeturina“:**

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në vendet e BEs dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bëjnë atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrohej mundësia që të i kryenin furnizimet në këto dyqane.

Komunat mundën të luajn rolin e tyre që të i promovojnë këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të e lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do ti ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

**Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante „zero mbeturina“:**

Komuna do të shpërndaj falas apo me bashkëfinancim komposterë individual të cilët do të reduktojnë mbeturinat që do të hudhen në kontejnerët apo shportat që do të grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

Vitet	2023	2024	2025	2026	2027
Komposter individual, numri	640	640	640	640	640

**Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.**

Komuna do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektive.

## 2.12 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 3 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 26: Korniza strategjike e Objektivit 2								
Nr.	Masat / aktivitete / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
2.1	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar			1			
2.2	Studim i fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit dhe modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale	Studimi i fizibilitetit është zbatuar		1				
2.3	Zgjerimi i mbulimit me shërbim të ndarjes së mbeturinave në burim	% EF me shërbim të ndarjes në burim		10%	20%	30%	40%	50%
2.4	Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese	% e riciklimit të plastikës, letres, kartonit, qelqit dhe metalit.	0%	5%	10%	15%	20%	25%
2.5	Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese	% e riciklimit të mbeturinave ushqimore dhe mbeturinave tjera	0%	5%	10%	15%	20%	25%

		biodegraduese						
2.6	Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të reciklueshme jo degraduese	Operatori është kontraktuar			1			
2.7	Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese	Operatori është kontraktuar			1			
2.8	Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
2.9	Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit dhe riciklimit	Qendra e grumbullimit është funksionalizuar dhe futur në operim				1		
2.10	Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportimit dhe riciklimit të MND në komune.	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
2.11	Kontraktimi i operatorit të licencuar për MND	Operatori është kontraktuar				1		

### Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave në komunë

Analiza në fjalë nisët nga parashikimet demografike të popullatës.

Tabela 19: Parashikimet demografike të popullatës						
Vendbanimi	Numri i popullatës					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Qyteti (banorë)	5648	5648	5648	5648	5648	5648
Zona ruarle (banorë)	20703	20703	20703	20703	20703	20703
Total banorë	26351	26351	26351	26351	26351	26351

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në studimin e kompozicionit të mbeturinave nga komuna e Pejës.

Tabela 20: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Popullata	26351	26351	26351	26351	26351	26351
Gjenerimi PCP vjetor	413 kg/vit	413 kg/vit	413 kg/vit	413 kg/vit	413 kg/vit	413 kg/vit
Gjenerimi PCP ditor	1.1kg PCP	1.1kg PCP	1.1kg PCP	1.1kg PCP	1.1kg PCP	1.1kg PCP
Gjenerimi vjetor	10,882t/vit	10,882t/vit	10,882t/vit	10,882t/vit	10,882t/vit	10,882t/vit

Në lidhje me kompozicionit/ përbërjes së mbeturinave nuk është bërë ndonjë analizë. Analiza e gjenerimit rrjedhimisht do të bazohet në bazë të matjes ndërsa popullata nuk parashihet të rritet për periudhën planifikuese. Sa i përket kompozicionit analiza bazohet në studimin e qytetit të Pejës.

Tabela 21: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit						
	Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
%	Letër dhe karton	19.15%	19.53%	19.92%	20.32%	20.70%
	Qelq	6.45%	6.6%	6.7%	6.84%	6.90%
	Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34.45%	33.76%	33.09%	32.4%	31.77%
	Tekstil dhe veshjet	5.85%	5.73%	5.61%	5.5%	5.3%
	Pllastika	19.45%	19.84%	20.23%	20.64%	21%
	Metal	1.05%	1.03%	1%	0.98%	0.96%
	Të tjera	13.60%	13.87%	14.40%	14.5%	14.7%
	ton	Letër dhe karton	2 084	2 088	2 092	2 094
Qelq		702	703	704	705	706
Mbeturina bio-degraduese <sup>5</sup>		3 749	3 758	3 763	3 767	3 770
Tekstil dhe veshjet		637	638	639	640	640
Pllastika		2 117	2 121	2 124	2 127	2 129
Metal		114	114	114	115	115
Të tjera		1 480	1 483	1 485	1 488	1 489

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të caktuara të mbeturinave komunale si letra, plastika, qelqi, plastika dhe metali si dhe mbeturinat biodegraduese.

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komunat duhet që të zbatoj një **studim të fizibilitetit të riciklimit të mbeturinave në komunë**.

<sup>5</sup> Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

Tabela 22: Caqet e riciklimit					
Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
Të riciklueshmet jo-degraduese %	5%	10%	15%	20%	25%
Të riciklueshmet jo-degraduese (ton)	251	503	755	1 008	1 261
Të riciklueshmet biodegraduese %	5%	10%	15%	20%	25%
Të riciklueshmet biodegraduese (ton)	187	376	564	753	942

### Avancimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

- Zgjerimi i infrastrukturës për ndarje në burim të mbeturinave komunale;

Komuna e Obiliqit është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mundë të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë
- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastruktura ricikluese e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **plani i riorganizimit të shërbimit** që do ta zhvilloj komuna.

Në tabelën në vijim do të jepet orari i shtrirjes së ndarjes së mbeturinave në burim për komunën e Obiliqit:

Tabela 23: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi total me shërbim	100%	100%	100%	100%	100%	100%
Mbulimi me ndarje në burim	5%	10%	15%	25%	35%	45%

Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:

Komuna e Obiliqit do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese**. Studimi do të bazohet në analizën e



kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikat më të mira.

Sipas Strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu Strategjia e mbeturinave parasheh operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të tentoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
- zhvillimi i partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**. Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas Strategjisë secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MESPI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegradues do të zbattoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese
- zhvillimi i skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve sa i përket vajrave mbeturinë

#### **Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:**

- Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Obiliqit planifikon të hap **qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale**. Për hapjen e kësaj qendre komuna ka do ta caktoj lokacionin.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët mund të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna duhet përmes një **studimi të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës (qendrave) të analizoj dhe të vendos se a ta menaxhoj vetë këtë qendër apo ta angazhoj një operatorë privat.

#### **Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:**

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktin shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna jonë ende nuk e ka caktuar lokacionin e deponisë por do ta planifikoj këtë gjë në këtë plan. Komuna do ti dërgoj mbeturinat në këtë lokacion i cili do të operohet nga kontraktori i licencuar i cili poashtu do të kontraktohet nga komuna siq e parasheh ligji.

Komuna e ka parapar si kriter që në kuadër të lejes ndërtimore të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen dhe lokacioni ku do të dërgohen do të caktohet nga komuna. Poashtu inspeksioni do të mbikëqyrë zbatimin e këtij plani dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vendë të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendres rajonale komuna do ti dërgoj mbeturinat tek kjo qendër. Po ashtu tarifrat do të caktohen në nivel të komunave të cilat do të shërbehen nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Megjithatë komuna do të zbatoj një **studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit**. Poashtu ky fizibilitet do të jep paramasën e rehabilitimit të qendrës së riciklimit të MND në komunë.

#### **Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:**

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria përgjegjëse për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave te papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetësorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatoret publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

#### **Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:**

Sipas strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga thertoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në Halilaq të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë varrimin e tyre të gëlqelosur dhe njëkohësisht të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të

licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet e tyre.

Mishtoret, therrëtoret dhe industritë përpunuese të mishitduhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do ti hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

### Aktivitet vetëdijësuese për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqaroj se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

### 2.13 Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Tabela 24: Korniza strategjike e objektivit 3								
Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
3.1	Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	% e popullatës së shërbyer me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	85%	90%	95%	100%	100%	100%
3.2	Plani i ri operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është hartuar dhe miratuar	Plani operativ është hartuar / reviduar dhe miratuar	-	1				
3.3	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe	-	-	1	-	-	-

	të mbeturinave	transportit të mbeturinave është zbatuar						
3.4	Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin	-	-	1	-	-	-
3.5	Zgjidhja e statusit të rasteve sociale	Pagesa e faturave për rastet sociale është zgjidhur	-	-	1	-	-	-
3.6	Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave	Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave	20	15	15	10	10	5

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

#### **Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave**

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit dhe të dhënat e popullatës janë marrë nga ASK. Komuna është e përkushtuar që të zgjeroj ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që fillimisht të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

<b>Tabela 25: Strategjia e zgjerimit me shërbim</b>						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim tërë zona	85%	90%	95%	100%	100%	100%

#### **Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave**

#### **Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale**

Komuna do të përditësoj **planin operativ** i cili do të bëjë planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të rezultoj përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit:

- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale:

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmer **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

### **Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave të vëllimshme**

Komuna do të hap qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave tjera të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk guxojnë të hudhen në kontejnerë por të dërgohen në këto qendra.

Komuna do të zbatoj **fushatë informuese** përmes së cilës do të informoj qytetarët për këtë qendër, llojin e mbeturinave të cilat mund të dërgohen në këtë qendër, orarin e punës, etj.

### **Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të koston**

Komuna ka përcaktuar si objektivi përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të koston në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

### **Përmirësimi i efikasitetit të stafit**

Komuna duhet të planifikoj njërin apo kombinimin e aktiviteteve sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e regrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela 27: Efikasiteti i stafit**

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Stafi direkt						
Stafi indirekt dhe administrativ						
Amvisëritë e shërbyera						
Konsumatorët e shërbyer						
Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer						

Ideja është që stafi administrativ të zvogëlohet karshi stafit direkt

### **Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës**

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Hartimi i planit të ri operativ** (riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinjë apo funksional (second-hand)
- Ndërtimin e transfer stacionit për të shkurtuar distancën
- Përforcimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

### **Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit**

Komuna ka përcaktuar si objektivi përmirësimin e qendrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qendrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna
- Zgjidhja e pagesës së faturave për rastet sociale

## 2.14 Objektivi nr. 4: Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjete i fundit

Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
4.1	Pastrimi i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave	Pastrimi është realizuar	-	1	1	1	1	1
4.2	Fushatë informuese	Deponite ilegale reduktohen vazhdimisht	-	1	1	1	1	1
4.3	Inspektim dhe monitorim	Shqiptimi i gjobave		1	1	1	1	1

Rehabilitimi i deponive për të arritur standardet mjedisore

Rishikimi tarifor për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit



## 2.15 Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Nr.	Aktiviteti / Masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
5.1	Revidimi i RrK të MM	RrK e MM është reviduar	-	-	1	-	-	-
5.2	Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	Zyrtari i MM është emëruar/Sektori është formuar	1	-	-	-	-	-
5.3	Kalimi i procesit tariforë	Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar	-	-	1	-	-	-
5.4	Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale	Operatori i licencuar është kontraktuar	-	-	1	-	-	-
5.5	Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët	Programi zbatohet	-	-	1	-	-	-

### - Hartimi dhe miratimi i planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave

Komuna këtë obligim është duke e kryer gjatë vitit 2022. Plani parashihet të përfundohet deri në 15 nëntor dhe drafti do të paraqitet për miratim asamblesë komunale për miratim sipas procedurave në fuqi. Komuna planifikon që ta miratojë planin gjatë vitit 2022 dhe plani do të zgjas deri në vitin 2027 ku komuna parasheh të nënshtrohet procesit të revidimit siç parashihet me ligj.

### - Hartimi dhe miratimi i rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave

Komuna e ka miratuar rregulloren komunale të MM në vitin 2014 porse parasheh që të njëjtën ta revidoj gjatë vitit 2022 për të përditësuar ndryshimet që dalin nga amandamentimet ligjore, hartimin e strategjisë dhe planeve kombëtare për kategori të ndryshme të mbeturinave.

### - Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2014 me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

### - Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim në vitin 2014 me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

- **Kalimi i procesit tariforë**

Komuna e ka kaluar procesin tariforë në vitin dhe planifikon që ti nënshtrohet të njëjtit gjatë vitit 2023 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

- **Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët**

Ky program do të dizajnohet që ti ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

### **3 Plani i MM në kushte emergjente**

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme, andaj komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente.

#### 4 Plani financiar, monitorimit dhe veprimit

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet kapitale që do mbështesin realizimin e objektivave të planit të financuara përmes buxhetit të komunës, bashkëfinancimit me komunat tjera apo me qeverinë si dhe projektet e financuara nga burimet e jashtme si qeveria donatorët, apo kapitali privat.

Tabela 38: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 1 „Parandalimi dhe reduktimi“								
Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Riorganizimi i shërbimit				60,000 €			<b>60,000 €</b>	
o Plani i riorganizimit të shërbimit	DSHP			10,000 €			<b>10,000 €</b>	Komuna
o Sigurimi i infrastrukturës matëse	DSHP			50,000€			<b>50,000€</b>	Donacion
Zbatimi i tarifave volumetrike			10,000 €				<b>10,000 €</b>	
o Kalimi i tarifave PAYT (procesi)	DSHP		2,500 €				<b>2,500 €</b>	Komuna
o Azhurnimi i softuerit të faturimit	DSHP		7,500 €				<b>7,500 €</b>	Komuna
o Zbatimi i tarifave PAYT	KRM			x				KRM
Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset				2,500 €			<b>2,500 €</b>	
o Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal	DSHP			2,500 €			<b>2,500 €</b>	Komuna
o Pakoja e lehtësimeve fiskale	DSHP			x				Komuna
Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante <sup>6</sup>	DSHP	76,800 €	76,800 €	76,800 €	76,800 €	76,800 €	<b>384,000 €</b>	Donacion
Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit		700 €	700 €	700 €	700 €	700 €	<b>3,500 €</b>	Komuna
<b>Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave</b>		<b>77,500 €</b>	<b>87,500 €</b>	<b>139,700 €</b>	<b>77,500 €</b>	<b>77,500 €</b>	<b>450,000 €</b>	

<sup>6</sup>Furnizimi me komposterë: Vitet 2023, 2024 dhe 2025 nga 50 komposterë; vitet 2026 dhe 2027 nga 100 komposterë.

**Tabela 39: Plani financiar, veprimet dhe monitorimit - Objektiv 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“**

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave	DSHP		5,000 €				<b>5,000 €</b>	Komuna
Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale		5,000 €	5,000 €	110,000 €	5,000 €	5,000 €	<b>130,000 €</b>	
o Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit	DSHP			25,000 €			<b>25,000 €</b>	Komuna
o Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	<b>25,000 €</b>	Komuna
o Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve	DSHP			5,000 €			<b>5,000 €</b>	Komuna
o Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit	DSHP			75,000 €			<b>75,000 €</b>	Donatori
o Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajëra	DSHP	x	x	x	x	x		
o Bashkimi i skemës ndërkomunal të kompostimit	DSHP							Komuna
Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale		15,000 €	75,000 €				<b>90,000 €</b>	
o Studimi i fizibilitetit	DSHP	15,000 €					<b>15,000 €</b>	Komuna
o Ndërtimi i qendrës së grumbullimit/ripërdorimit <sup>7</sup>	DSHP		75,000 €				<b>75,000 €</b>	Komuna / donatori
o Funkcionalizimi i qendrës	DSHP			x				Komuna
Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi			28,000 €	150,000 €			<b>178,000 €</b>	
o Caktimi i lokacionit	DSHP							
o Kontraktimi i operatorit	DSHP		5,000 €				<b>5,000 €</b>	Komuna
o Caktimi i tarifave	DSHP		3,000 €				<b>3,000 €</b>	Komuna
o Studimi i fizibilitetit			20,000 €				<b>20,000 €</b>	
o Rehabilitimi i qendrës së MND <sup>8</sup>	DSHP			150,000 €			<b>150,000 €</b>	Komuna / donatori
o Bashkimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit	DSHP					x		Komuna
Menaxhimi i mbeturinave shtazore								
o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat		x	x					
o Inspektimi i zbatimit		x	x	x	x	x		
Menaxhimi i mbeturinave medicinale								
o Inspektimi i zbatimit		x	x	x	x	x		

<sup>7</sup> Për komunën e Obiliqit parashihet ndërtimi i një qendretë ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përcjellëse të qendrës si rrethoja, kamerat, bazamenti, kontejnerët, etj.

<sup>8</sup>Fizibiliteti, rrethoja, makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

Fushatat e vetëdijësimit		700 €	700 €	700 €	700 €	700 €	3,500 €	Komuna
<b>Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi</b>		<b>20,700 €</b>	<b>163,700 €</b>	<b>330,700 €</b>	<b>5,700 €</b>	<b>5,700 €</b>	<b>406,500 €</b>	

**Tabela 32: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektiv 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“**

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		40,000 €	121,000 €	261,000 €	121,000 €	121,000 €	<b>664,000 €</b>	
o Përditësimi i planit operativ	DSHP	25,000 €					25,000 €	Komuna
o Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit	DSHP		100,000 €				100,000 €	
o Furnizimi me shporta 120 l <sup>9</sup>	DSHP	12,000 €	12,000 €	12,000 €	12,000 €	12,000 €	60,000 €	Donator
o Furnizimi me shporta 240 l <sup>10</sup>	DSHP	3,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	3,000 €	15,000 €	Donator
o Furnizimi me shporta të rrugëve	DSHP		1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	4,000 €	KRM
o Furnizimi me kontejnerë metalik 1.1 m3	DSHP		5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	20,000 €	Donator
o Furnizimi me kamionë <sup>11</sup>	KRM			100,000 €	100,000 €	100,000 €	300,000 €	Donator
o Furnizim me autocisternë	KRM			100,000 €			100,000 €	Donator
o Furnizim me autofshesa	KRM			40,000 €			40,000 €	Donator Komunë
Përmirësimi i performancës operative dhe financiare		- €	15,000 €	- €	- €	- €	15,000 €	
o Marrja përsipër e faturimit nga komuna	DSHP/KRM			x				Komuna
o Zhvillimi i softuerit të faturimit	DSHP/KRM		15,000 €				15,000 €	Komuna
o Monitorimi i performancës	DSHP/KRM	x	x	x	x	x		Komuna
Kampanja informative	OJU	750 €	750 €	750 €	750 €	750 €	3,500 €	
<b>Total objektiva 3 - Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme</b>		<b>40,750 €</b>	<b>136,750 €</b>	<b>261,750 €</b>	<b>121,850 €</b>	<b>121,850 €</b>	<b>682,500 €</b>	

<sup>9</sup>Çdo vit nga 600 shporta 120 l

<sup>10</sup>Çdo vit nga 100 shporta 240 l

<sup>11</sup>Furnizim me 3 kamion të vegjël 4t

**Tabela 34: Plani financiar, veprimet dhe monitorimit - Objektiv 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“**

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Revidimi i RrK të MM	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	DSHP							Komuna
Kalimi i procesit tariforë	DSHP			3,500 €			3,500 €	Komuna
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve	DSHP	15,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	75,000 €	Komuna
Hartimi i planit të menaxhimit të shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente si pjesë e planit të emergjencave të komunes.			3,000 €				3,000 €	
<b>Total objektiva 5–Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale</b>		<b>15,000 €</b>	<b>23,000 €</b>	<b>23,500 €</b>	<b>15,000 €</b>	<b>15,000 €</b>	<b>91,500 €</b>	